



Pranuar / Dërguar Priljen / Predato Received / Delivery	04 . 10 . 2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHEK	6390/2023		1/4



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1112/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë me Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.1112/2023 të datës 24.08.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] nga Komuna e Vitisë, kundër Renditjes Përfundimtare me numër reference RN00011027 të datës 05.07.2023 lidhur me konkursin për pozitën e punës "Zyrtar për Tatim në Pronë" në Komunën e Kamenicës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.10.2023 morri këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.1112/2023 e datës 24.08.2023e parashtruar nga ankuesi [redacted].

A r s y e t i m

Komuna e Kamenicës më datë 16.02.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me numër reference RN00011027 për grupin Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm respektivisht për pozitën „Zyrtar për Tatim në Pronë“ ku afati për aplikim ka qenë nda data 09.03.2023 deri më datën 16.03.2023. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, ku përmes Listës me numër reference RN00011027 të datës 05.07.2023 të Njësisë së Personelit të Komunës së Kamenicës është njoftuar lidhur me renditjen si i treti në listë.

Ankuesi i pakënaqur me Listën përfundimtare të kandidatëve fitues për konkursin me numër reference RN00011027 për grupin Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën e punës „Zyrtarë për Tatim në Pronë“ për dy pozita të lira, më datë 24.08.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 5800/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 24.08.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Kamenicës. Ndërsa Këshilli me datë 30.08.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 5800/2023 të datës 24.08.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailat e datës 18.08.2023; Lista e kandidatëve për verifikimin paraprak e datës 21.03.2023; Njoftimi përfundimtar i verifikimit paraprak i datës 27.03.2023; Rezultatet përfundimtare të vlerësimit të datës 19.04.2023; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 05.07.2023; Aktvendim me numër 02609671 i datës 31.07.2023; Pliko me numër R 2650311e datës 24.08.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 24.08.2023; Përgjigje në ankesë e datës 30.08.2023; Konkurs me numër reference RN00011027 i datës 09.03.2023; Listë e aplikantëve, Vendim me numër Nr.39137 i datës 12.12.2022; Akt Emërim me numër Nr.570/98 i datës 20.07.2011; Akt Emërim me numër Nr.439/15 i datës 20.02.2011; Ndryshim dhe Plotësim i Aktit të Emërimit i datës 22.01.2015; Akt Emërim me numër Nr.14.05.2012; Akt Emërim me numër Nr.37811 i datës 08.09.2017; Vendim me numër Nr.14672 i datës 06.05.2022; Ankesat e datës 19.04.2023; Vendim me numër Nr.14724 i datës 24.04.2023; Aplikacioni i datës 13.03.2023; Diplomë me numër Nr.300-S/18 e datës 03.12.2018; Vendim me numër Ref.nr.6-1916 i datës 11.07.2018; Diplomë me numër 828 e datës 16.06.1988; Certifikatë e datës 23.09.2022; Certifikatë maj 2022; Certifikatë e datave 13,14,15 dhjetorë 2019; Certifikatë me numër Nr.2320/19 e datës 10.09.2019; Vërtetim me numër 39001/2012 i datës 12.09.2018; Licencë me numër 01-154/21 e datës 23.06.2021; Vërtetim i datës 12.09.2018; Certifikatë e datës 05.01.2002; Pasqyra e llogarisë së trustit për periudhën 01.08.2002 deri më 20.04.2022; Kontratë mbi vepër me numër nr.02-112/14-368 e datës 02.06.2021; Kontratë mbi vepër me numër 02.-112/11-175 e datës 18.02.2022; Marrëveshje për shërbime të veçanta me numër 02-035/02-797 e datës 03.08.2022; Certifikatë mbi dënimet penale e datës 06.01.2023; E-mail i datës 28.09.2023; Aplikacion i datës 15.03.2023; Certifikatë mbi dënimet penale e datës 14.03.2023; Diplomë e datës 05.07.2012; Diplomë me numër Nr.1032/18 e datës 09.07.2018; Diplomë me numër nr.1910/20 e datës 15.10.2020; Letërnjoftim; Pasqyra e llogarisë së trustit për periudhën 01.08.2002 deri më 14.03.2023; Shkresë e datës 18.11.2022; Vërtetim i datës 07.02.2023; Aplikacion i datës 09.03.2023; Certifikatë mbi dënimet penale e datës 09.03.2023; Diplomë Nr.69/2016 e datës 04.10.2016; Letërnjoftim; Certifikatë e datës 30.09.2022; Pasqyra vjetore e llogarisë për periudhën kohore 01.01.2022 deri më 31.12.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e palejuar, sepse:

Nga administrimi i provave, Kolegji ka gjetur se Komuna e Kamenicës më datë 09.03.2023 ka publikuar konkursin me numër reference Nr.ref.RN00011027 për pozitën e punës „ Zyrtar i Tatimit në Pronë” për dy pozita, klasa e pozitës Profesional 3. . Në këtë konkurs në bazë të listës së kandidatëve ka aplikuar dhe ankuesi, i cili në bazë të njoftimit të datës 27.03.2023 të publikuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Kamenicës është përfshirë në listën e ngushtë duke i'u nënshtruar procedurave të tjera të pranimit (testit me shkrim, intervistës me gojë dhe vlerësimit të jetëshkrimit). Pas përfundimit të rregullt të procedurës së pranimit për pozitën e lartcekur, Njësia e Burimeve Njerëzore më datë 19.04.2023 ka publikuar njoftimin për rezultatet

përfundimtare të vlerësimit ku rezulton se ankuesi është vlerësuar me gjithsejtë tetëdhjetë pikë pesë (80.5) pikë të përgjithshme duke u renditur i dyti në listë. Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Kamenicës në këshillin juridike të njoftimit, palëve të pakënaqura me këtë njoftim i 'u është dhënë e drejta për ankesë brenda afatit prej tre (3) ditësh në Komisionin e Pranimit.

Më datë 19.04.2023 kandidati S.K i cili në bazë të njoftimit përfundimtar të publikuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore ishte vlerësuar me shtatëdhjetë e katër pikë gjashtë (74.6) pikë, ka parashtruar dy ankesa pranë Komisionit të Pranimit, lidhur me rivlerësimin e intervistës me gojë dhe poentimin e jetëshkrimit. Komisioni i Pranimit më datë 24.04.2023 ka nxjerrë Vendim me numër Nr.14724, përmes të cilit e ka aprovuar ankesën e ankuesit duke e bërë rishqyrtimin e vlerësimit të jetëshkrimit dhe intervistës me gojë për kandidatin S.K.

Tutje më datë 05.07.2023 Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Kamenicës, ka publikuar renditjen përfundimtare të kandidatëve fitues pas procesit të ankimimit ku ankuesin e ka renditur të tretin në listë me tetëdhjetë pikë pesë (80.5) pikë të përgjithshme ndërsa kandidatin S.K e ka renditur të dytin me tetëdhjetë pikë gjashtë (80.6) pikë të përgjithshme .

Ankuesi më datë 19.07.2023, ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorin Themelore të Gjilanit kundër zyrtarit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Kamenicës, ndërsa Prokuroria Themelore e Gjilanit më datë 31.07.2023 ka nxjerrë Aktvendimin me numër PP.I.nr.120/2023 me të cilin e ka hedhur kallëzimin penal të parashtruar nga ankuesi kundër të dyshuarit B.K, me arsyetimin se ne asnjë prove nuk është vërtetuar se i dyshuari B.K ka kryer veprën penale Keqpërdorim i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar nga neni 414 i KPRK-së. Tutje ne aktvendim është theksuar edhe fakti se ne baze të njoftimit të datës 05.07.2023 janë shpallur rezultatet me rekomandimin e komisionit vlerësues për pozitën e punës „Zyrtar të Tatimit në Pronë“, ashtu që palëve të pakënaqura i është dhënë mundësia që brenda afatit 30 ditësh të mund të paraqesin ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa i pandehuri nuk ka ofruar dëshmi se e ka shfrytëzuar të drejtën e garantuar me ligj, gjegjësisht të drejtën e ankimimit, por i njëjti para se të kalojë afati i ankesës ka deponuar kallëzimin penal në prokurori .

Kolegji i Këshillit, pas analizimit të të gjitha provave dhe fakteve të parashtruara nga palët në procedurë ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht nenin 125 paragrafi 1 i cili ka përcaktuar se: *“Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: “heshtja administrative”).*

Duke marr parasysh afatin për parashtrimin e ankesës ndaj aktit administrativ, Kolegji i Këshillit, ju referua nenit 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili shprehimisht përcakton: *“Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data kur është njoftuar për aktin administrativ”,* si rrjedhojë meqenëse ankuesi Elbasan Aliu lidhur me pakënaqësitë e rezultatit të vlerësimit përfundimtarë për konkursin me numër me numër reference RN00011027 të datës 09.03.2023 njoftimin e ka pranuar më datë 05.07.2023, ndërsa ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar më datë 24.08.2023, mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, konstaton se ankesa me numër protokollit 5800/2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të

Kosovës është parashtruar në kundërshtim me afatin e përcaktuar si më lartë, nga kjo rrjedh se ankesa e ankuesit është e pasafatëshme dhe si e tillë është e palejuar në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, nisur nga konstatimet si me lartë, Kolegji në mbështetje të nenit 129 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1112/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Kamenicës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.